



VOICE OF ROMA, ASHKALI  
AND EGYPTIANS IN KOSOVO

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br. <u>417/23</u>
Nr. i fq. / Br. st _____
Data: / Datum <u>03 04. 2023</u>
VUSHTRRI - VUČITRN



**KOMUNA VUSHTRRI**

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur më dt. 23.03.2023, në mes:

- Organizata Jo-Qeveritare “Zëri i Romëve, Ashkalinje dhe Egjiptianëve” (me tej ne tekst ‘Organizata’) të cilën e përfaqëson z. Isak Skenderi, Drejtor Ekzekutiv, me numër të regjistrimit 5113364-1, me adresë në rrugën Rr. "Ali Pashë Tepelena", Aktash, 10000, Prishtinë
  - dhe
- Komuna e Vushtrrisë, (me tej ne tekst ‘Komuna’) e përfaqësuar nga z. Ferit Idrizi, Kryetari i Komunës

### **Neni 1 Qëllimi i Marrëveshjes**

Qëllimi i kësaj marrëveshje është përcaktimi i bashkëpunimit në mes të Komunës e Vushtrrisë dhe Organizatës për implementim dhe financimin e qendrës përmesim shtesë në Prelluzhë në komunën e Vushtrrisë bazuar në UA Nr.19/2018 dhe ofrimi i mbështetjes teknike përmenaxhimin e qendrës dhe ngritjen e kapaciteteve të stafit përgjegjës.

### **Neni 2 Qëllimet specifike**

- 2.1 Mbështetja institucionale, financimi dhe menaxhimi i qendrës mësimore në fshatin Prelluzhë nga Komuna e Vushtrrisë,
- 2.2 Regjistrimi i qendrës mësimore në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nga Komuna e Vushtrrisë,
- 2.3 Zbatimi i programit të qendrës mësimore në Prelluzhë që synon përfshirjen e fëmijëve të pa favorizuar social në arsimin e rregullt nga Komuna e Vushtrrisë,
- 2.4 Ngritja e kapaciteteve përmonitorim dhe cilësi të ofrimit të shërbimeve në qendrën mësimore nga organizata joqeveritare Zëri i Romëve, Ashkalinje dhe Egjiptianëve.



## KOMUNA VUSHTRRI

### Neni 3

#### Kushtet dhe parimet e përgjithshme të të dyja palëve

Komuna dhe Organizata zotohen që do të ndjekin politikat dhe legjislacionin në fuqi për implementimin e punës së qendrës mësimore në Prelluzhë.

### Neni 4

#### Veprimet dhe përgjegjësitë konkrete të Komunës së Vushtrrisë

Bazuar në UA Nr.19/2018 të MASHTI-të, ku parashihet themelimi dhe funksionimi i qendrave mësimore, dhe regjistrimi i qendrave mësimore në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) Komuna e Vushtrrisë merr përsipër:

- 4.1 Menaxhimin e qendrës mësimore duke filluar nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshje dhe duke u bazuar në standartet e specifikuara në UA të cekura më lartë duke përfshirë:
  - 4.1.1 Aplikimin e programit ekzistues për mësim plotësues;
  - 4.1.2 Kontraktimi i stafit sipas dispozitave ligjore në fuqi;
  - 4.1.3 Implementimi i rregullores së punës dhe rregullores për mbrojtjen e fëmijëve si dhe
  - 4.1.4 Implementimi i planit të punës dhe planit financiar.
- 4.2 Regjistrimi i qendrës mësimore ekzistuese në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) me vendndodhje në fshatin Prelluzhë;
- 4.3 Planifikon dhe ndan buxhetin për implementimin e programit të qendrës mësimore, ku buxheti bazë i qendrës mësimore për 1 vit është 10,944.00 Euro;
  - Pagesën e 2 mësimdhënësve (tutorëve) të qendrës mësimore për 12 muaj në vlerën totale 8,400.00 €
  - Pagesa e hapësirës me qira për qendrën mësimore për 12 muaj në vlerën totale 1,800.00 €
  - Materiale didaktike dhe internet për 12 muaj në vlerën totale 744.00 €
- 4.4 Krijon hapësirën për vendosjen e stafit të qendrës mësimorë ne listën e pagave te komunës;
- 4.5 Përcakton personin (koordinator) përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e qendrës mësimore;
- 4.6 Merr përsipër të raportoj pjesën narrativë dhe financiare në MASHTI sipas Udhëzuesit të UA 19/2018.
- 4.7 Komuna pas tre viteve mbanë përgjegjësin e plotë për menaxhimin dhe funksionimin e qendrës mësimore deri në një vendim tjeter nga MASHTI.

### Neni 5

#### Veprimet dhe përgjegjësitë konkrete të OJQ Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve

- 5.1 Organizata do t'i ofrojë komunës mbështetje teknike në procesin e aplikimit për regjistrimin e qendrës mësimore në MASHTI.
- 5.2 Organizata do të investoj në ngritjen e shkathtësive dhe kapaciteteve të zyrtarëve komunal, koordinatorit të qendrës mësimore, dhe punonjësve të qendrës mësimore për aplikim sa më të mirë të standardeve të përcaktuara me UA për qendrat mësimore nga MASHTI.



VOICE OF ROMA, ASHKALI  
AND EGYPTIANS IN KOSOVO



## KOMUNA VUSHTRRI

5.3 Organizata do të investon në ngritjen e nivelit të komunikimit ndërmjet nivelit lokal dhe qendrorë për ndryshimet ose vendimet eventuale për qendra mësimore.

### Neni 6 Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit dhe zbatohet nga 01 janari 2023 dhe është vlershme deri në kalimin e plotë të përgjegjësive te Komuna, por jo më gjatë se deri më **31 Dhjetor, 2025**.

### Neni 7 Kushtet e Veçanta

7.1 Kjo marrëveshje është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri kopje origjinale, dy prej të cilave janë për komunën dhe një për organizatën.

7.2 Ndryshimet në këtë marrëveshje mund të bëhen vetëm me pëlqimin e të dyja palëve me nënshkrim të aneks marrëveshjes.


7.3 Çdo mosmarrëveshje lidhur me këtë marrëveshje bashkëpunimi do të preferohet të zgjidhet me mirëkuptim. Në rast se Palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjet me mirëkuptim midis tyre, atëherë palët janë të obliguara të njoftojnë palën tjetër 30 ditë më herët për shkëputjen e marrëveshjes.

## PALËT NËNSHKRUUESE

**Komuna e Vushtrrisë**

Kryetari i Komunës

**z. Ferit Idrizi**



**OJQ” Zëri i Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptianëve”**

Drejtore Ekzekutiv

**z. Isak Skenderi**

